

VENDIM

Nr. 1239, datë 16.12.2009

PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.618, DATË 7.9.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pika 1, e 20, pika 3, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në fund të pikës 17 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Pagesa për personat me aftësi të kufizuar dhe kujdestarët e tyre bëhet nga shërbimet bankare, që funksionojnë pranë njësisë së qeverisjes vendore, ku ka vendbanimin përfituesi ose nga shërbimi postar për njësitë e qeverisjes vendore, ku nuk ka një të tillë.”.

2. Shkronja “b” e pikës 19 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Certifikatën personale ose kopjen e letërnjoftimit.”.

3. Shkronja “a” e pikës 20 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ a) Kopje të letërnjoftimit, të personit kujdestar;”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2010.

Kryeministri

Sali Berisha